

ORTAKËT THEMELUES

Z. Bajram LEKA
AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË "ALB ProPower" SH.P.K.

Sot, më datë 21/10/ 2022,

Z. Bajram Leka, shtetas Shqiptar, i biri i Skenderit, lindur më 13/03/1994, në Muhurr/Shqipëri, banues në Tiranë/Shqipëri e mbajtës i ID me nr. J40313108T, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "**ALB ProPower**" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1 **EMËRTIMI**

Emri i Shoqërisë është "**ALB ProPower**" Sh.p.k.

NENI 2 **SELIA**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga e Kavajës, Godina Millenium Business, Kati i 8, Apartamenti 1, Tiranë, Shqipëri.

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

NENI 3 **KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

NENI 4 **OBJEKTI**

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- **Fushën e projektimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të zbatimit.**
- **Projektim arkitektonik dhe urbanistik, projektim konstruktiv, instalator, projekte elektrike, projekte mekanike, projekte civile vepra hidrike, ujësjelles, kanalizime, rrugë, hekurudha, ura, vepra arti, sinjalistikes rrugore.**
- **Mbikqyrje & kolaudim**

- Tregtim me shumicë dhe pakicë, import-eksport i materialeve, makinerive, pajisjeve dhe impianteve të ndryshme elektrike, impianteve/paneleve fotovoltaike, sistemeve/impianteve termike, të ftohjes e ngrohjes (kondicionimit), sisteme ndriçimi, telekomunikacionit si dhe impianteve të tjera të ngjashme të destinuara për objekte civile dhe industriale, për sektore të ndryshme.
- Shitja me shumicë dhe pakicë brenda dhe jashtë vendit të materialeve të ndryshme elektrike dhe pajisjeve të tyre të të gjitha llojeve të materialeve të tjera industriale, si impiante ndriçimi, impiante të energjisë alternative, impiante të mbrojtjes nga ngarkesat atmosferike, impiante portash, barrierash dhe kontrollit të dedikuar, impiante kundra grabitjes, zjarrit, përmbytjeve dhe gazrave, impiante video-vëzhgimi CCTV dhe speciale, impiante për transmetim të dhënash dhe telekomunikacioni etj.
- Ofrimi i konsulencës dhe asistencës teknike për projektimin, supervizimin komisionimin dhe mirëmbajtjen e impianteve elektrike civile apo industriale si dhe të sistemeve të energjisë së rinovueshme.
- Import eksport mallra e pajisje të teknologjisë në fushën e energjitikeës etj, që do të përdoren në ndërtimin, mirëmbajtjen, dhe menaxhimin e centralit me impjante fotovoltaike e forma të tjera të prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme.
- Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, si dhe mund të kryejë çdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj.
- Tregtim të artikujve të ndryshëm industrial dhe ofrimi i shërbimeve me këto artikuj.
- Konsulencë inxhinierike sipas termave nderkombetare.
- Konsulencë Mjedisore
- Pergatitja e studimeve dhe vlersimeve mjedisore.
- Konsulencë për Auditimin e energjisë.
- Konsulencë teknike për sigurinë dhe shëndetin në punë (HSE).
- Konsulencë teknike për QC/QA në të gjitha fushat si ato civile, elektike, mekanike etj.
- Vlersimi i makinerive, pajisjeve dhe linjave teknologjike.
- Projektim i sinjalistikes rrugore, për të gjitha kategoritë e saj.
- Identifikimin e risqeve inxhinierike, minimizimin e risqeve dhe monitorimin e tyre.
- Mbrojtja nga zjarri/ sistemet e sigurisë.
- Relacion teknik i detajuar i impjanteve teknologjike.
- Referenca teknike dhe ligjore për hartimin e projekteve.
- Studime fizibiliteti.
- Studimi dhe pergatitja e projekteve mbi masat e mbrojtjes nga zjarri të ndërtesave të cdo lloji.
- Punime karpentiere metalike.

- **Instalimi i impjanteve ngritëse dhe transportuese (Ashensor, shkallë levizese etj) mirmbajtja e tyre.**
- **Instalimi i impjanteve termike –ventilim –kondicionim të ajrit, mirmbajtja e tyre.**
- **Instalimi i impjanteve higjienike, kuzhina, lavaxteri, hidrosanitare, mirmbajtja e tyre.**

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të ngjashëm apo të përafërt me të vetin. Gjithashtu, brenda kufijve të përcaktuar nga ligji mund të lëshojë garanci, letra dëmshpërblimi dhe çdo garanci tjetër reale.

Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

NENI 5 KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 10.000 (Dhjetë mijë) Lekë dhe është i ndarë në 1 kuotë.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Bajram Leka**, zoteron 1 kuotë, me 100 % të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 10.000 (Dhjetë mijë) Lekë të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6 ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjisllacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, **Z. Bajram Leka**, i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7 LEGJISLLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8
DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues të shoqërisë.

ORTAKËT THEMELUES

Z. Bajram Leka

Bajram Leka

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'Bajram Leka', with a large, stylized flourish extending to the left.